



Pranimar / Dorozuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	28.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAINSHK	5440/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.956/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktvendimit A.nr.802/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.37/2021 të datës 29.01.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë:
kundër organit të punësimit Komunës së Shtimes, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.37/2021 e datës 29.01.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, që ankueses t’ia bëjë kompensim në mënyrë retroaktive në vlerën e diferencës prej një e gjysmë (1.5) të koeficientit për periudhën kohore nga data 05.05.2020 deri e datë 31.01.2023 sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa për periudhën nga data 01.02.2023 deri me datë 30.04.2023 diferencën në pagë prej 162.22 Euro/cent në bazë mujore.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Shtimes që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitiv, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Komunën e Shtimes, me datë 29.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 15.10.2020 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me ankesën e ankues të parashtruar me datë 06.10.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, me pretendimet ankimore se institucioni punëdhënës është duke e dëmtuar dhe diskriminuar ankuesen në pagë, ngase sipas shkresës së datës 27.11.2014 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike lidhur me përcaktimin e koeficienteve, sipas së cilës shkresë për pozitat "Zyrtar Certifikues" koeficienti duhet të jetë nëntë (9), kurse ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 05.02.2013 e ushtron këtë pozitë mirëpo vazhdon të paguhet me koeficient e pagës shtatë e gjysmë (7.5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.37/2021 të datës 05.03.2021 e kishte hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankueses të datës 29.01.2021 me arsyetimin se ankuesja, ankesën në Këshill e kishte parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ankuesja kundër vendimit të Këshillit kishte hapur konflikt administrativ, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.704/2021 të datës 05.09.2023, e kishte refuzuar padinë e paditëses të datës 29.03.2021.

Ankuesja, kundër Aktgjykimit A.nr.704/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 14.06.2023 nxjerrë Aktvendimin AA.nr.802/2022 përmes të cilit e aprovon si të bazuar ankesën e ankueses, ndërsa e anulon Aktgjykimin A.nr.704/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë pikëpamjet juridike dhe konstatimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative të dhëna përmes Aktvendimit A.nr.802/2022 të datës 14.06.2023 si dhe duke u mbështetur në nenin 119 ndërlidhur me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shqyrtuar meritore ankesën e ankueses të datës 29.01.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktvendimin AA.nr.802/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative të datës 24.06.2023; Aktgjykimin A.nr.704/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 05.09.2022; Vendimin e Këshillit A.nr.37/2021 të datës 05.03.2023; Procesverbalin e datës 05.03.2021; Ankesën me numër te protokollit 348/2021 të datës 29.01.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Kërkesa e ankueses e datës 05.05.2020 për harmonizimin e koeficientit; Përgjigjen e datës 22.09.2020 të Menaxherit të Personelit; Ankesën e ankueses të parashtruar në Komisionin e Ankesave të Komunës së Shtimes; Fletë pagesë e datës 06.10.2020; Njoftimin e datës 15.10.2020 të Menaxherit të Personelit; Shkresën e datës 27.11.2014 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit të ankueses i datës 05.02.2013; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; E-mailin e ankueses të datës 28.01.2021 dërguar në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.02.2021; Përgjigjen

në kërkesë e datës 12.02.2021; Përshkrimi i detyrave të punës së ankues; Procesverbali i seancës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë i datës 30.08.2022; Autorizimin e datës 30.08.2022; Fletë thirrje e datës 29.07.2022; Përgjigje në padi e datës 02.06.2022; Aktvendimin A.nr.704/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 28.04.2023; Padinë e ankueses të datës 29.03.2021; E-mailin e datës 02.06.2022 dërguar nga A.N për Këshillin me korrespondencën e bashkangjitur; Shkresën e datës 27.07.2023 me shifër:02/120 te Njesisë për menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e administruara të lëndës, respektivisht në bazë të Aktit të Emërimit të datës 05.02.2013, ka konstatuar se ankuesja e mban pozitën "Përgjegjëse për Aprovimin e Shpenzimeve-Çertifikuese" në kuadër të Komunës së Shtimes dhe paguhet sipas koeficientit shtatë e gjysmë (7.5), ndërsa e njëjta me datë 05.05.2020 ka parashtruar kërkesë te Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes lidhur me harmonizimin e koeficientit, gjegjësisht kërkesën që koeficienti t'i bëhet nëntë (9), kërkesë e cila me datë 22.09.2020 nga Menaxheri i Personelit nuk aprovohet, kurse ankuesja me datë 06.10.2020 i drejtohet me ankesë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa Menaxheri i Personelit përmes shkresës së datës 15.10.2020 i përgjigjet ankueses se e njëjta mund të parashtrojë direkt ankesë në Këshill sipas dispozitave të nenit 24 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja, me datë 29.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshill, mirëpo në përgjigjet e dhëna të datës 10.02.2021 dhe 06.02.2022 nga institucioni punëdhënës, gjegjësisht Komuna e Shtimes nuk ka mundur ta provojë faktin se kur e ka pranuar ankuesja përgjigjen e datës 15.10.2020 sikurse përcaktohet me nenin 119 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj duke vepruar sipas Aktvendimin AA.nr.802/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 14.06.2023, ankesa e ankues është shqyrtuar në mënyrë meritore pasi që paraprakisht përmes vendimit A.nr.37/2021 të datës 05.03.2021 ishte hedhur poshtë si e palejuar.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses lidhur me harmonizimin e koeficientit për pozitën "Zyrtare Çertifikuese", Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës", si dhe nenin 3 paragrafi 2. Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë" sikurse e ka analizuar edhe nenin 43 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili asaj kohe e ka rregulluar të drejtën për trajtim të barabartë në Shërbimin Civil, e ku përcaktohej se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, moshë ose prejardhja etnike" si dhe nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili rregulloj të drejtën e pagës dhe shpërblimit të drejtë, ku përcaktohet se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave."

Po ashtu, në bazë të shkresës me numër të protokollit:6038 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike, është konstatuar po ashtu fakti se për pozitën "Zyrtar Certifikues" koeficienti duhet të jetë nëntë (9), sikurse përmes përgjigjes së datës 27.07.2023 të dhënë nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Shtimes është konstatuar fakti se ankueses pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i është rregulluar apo harmonizuar koeficienti sipas sistemit të ri të pagave nga data 01.05.2023 e tutje dhe e njëjta është caktuar sipas ekuivalentimit të koeficienteve në pozitën Drejtues i Ulët GJ6-7.2 lidhur me përshkrimin e vendit të punës sipas aktit të emërimit.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresën e përcjellë me datë 27.07.2023 nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Shtimes, ka konstatuar se sipas listës së pagave për vitin 2023, gjegjësisht ankuesja pavarësisht kërkesës së bërë me datë 05.05.2020 për harmonizimin e koeficientit nga shtatë e gjysmë (7.5) në nëntë (9), e njëjta vazhdimisht është paguar sipas koeficientit 7.5 deri me datë 31.01.2023, prandaj mbështetur nga konstatimet e dhëna si më lartë pretendimi ankimor i ankueses për harmonizimin e koeficientit të ankueses sipas kërkesës së datës 05.05.2020 të parashtruar pranë Njësisë për Menaxhimin e Personelit të Komunës së Shtimes është i bazuar dhe mbi këtë bazë institucioni punëdhënës është i obliguar që ankueses t'ia bëjë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive në vlerën e diferencës prej një e gjysmë (1.5) të koeficientit për periudhën kohore nga data 05.05.2020 deri e datë 31.01.2023 sipas sistemit të vjetër të pagave.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se për shkak se ankueses çështja e koeficientit nuk iu është harmonizuar me kohë respektivisht para se të hyjë në fuqi ligji i ri i pagave, ashtu që e njëjta edhe pas hyrjes së ligjit të ri të pagave në fuqi me datë 05.02.2023 është dëmtuar në pagë ngase për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2023 sipas listës së pagave të ofruara nga institucionin është pagur në vlerën e pagës prej 582.31 Euro/cent (mesatarja e tre muajve), ndërsa pas harmonizimit të koeficientit apo ekuivalentimit dhe korrigjimit të koeficienteve nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, e njëjta nga data 01.05.2023 vazhdon të paguhet sipas kategorizimit për pozitën Drejtues i Ulët GJ6-7.2 sipas ligjit të ri të pagave për përshkrimin e njëjtë të vendit të punës sipas aktit të emërimit, prandaj nga se u tha si më lartë institucionin punëdhënës është i obliguar që ankueses t'ia bëjë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive edhe për periudhën nga data 01.02.2023 deri me datë 30.04.2023 për diferencën në pagë prej 162.22Euro/cent në bazë mujore.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses që t'ia njihet e drejta për kompensim retroaktiv që nga data 27.11.2014 sipas shkresës me numër të protokollit:6038 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike kur ishte rregulluar çështja e koeficientit për pozitën e "Zyrtarit Certifikues", Kolegji i Këshillit thekson faktin se ligji material nuk e ka rregulluar çështjen e afateve kohore për kompensimet materiale, andaj mbështetur edhe në Mendimin Juridik Nr.42/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27.02.2023 dhe duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, gjegjësisht nenit 87 të tij ku përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", andaj mbi këtë bazë konstatohet fakti se afati kohor për realizimin e kësaj të drejte është parashkruar ngase nëse i referohemi datës 05.05.2020 kur ankuesja kishte parashtruar fillimisht kërkesë pranë institucionit për harmonizimin e koeficientit sipas shkresës së datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC/ Ministrisë së Administratës Publike të, kanë kaluar më shumë se tre (3) vite, prandaj mbështetur në këtë konstatim ky pretendim ankimor nuk është i bazuar respektivisht është i jashtëafatshëm.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas administrimit të shkresave të lëndës, analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovojë pjesërisht ankesën e ankueses sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ashtu që ankueses i është njohur e drejta për kompensim retroaktiv, mirëpo vetëm nga momenti i parashtrimit të kërkesës së saj fillestare me datë 05.05.2020 pranë institucionit punëdhënës deri me datë 30.04.2023, kurse çështja e harmonizimit të koeficientit tani më i është rregulluar sipas konstatimit të dhënë si më lartë nga rrjedh se ky pretendim është përmbushur, ndërsa pretendimi ankimor i ankuese për kompensim retroaktiv dhe atë që nga data 27.11.2014 i është refuzuar për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, nga rrjedh se institucionin punëdhënës, gjegjësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Komunës së Shtimes janë të obliguar të veprojnë sikurse është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.956/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAJTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën Shtimes, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.